



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prilato Received/Prilozhy	26.04	702	2	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSHCK	2428/2022		1/3	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.242/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.242/2022 të datës 16.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

Komuna e Mitrovicës, kundër Vendimit me Ref.Auv,01-405/2021 të datës 30.08.2021 të Komisionit Disiplinor të Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 26.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.242/2022 e datës 16.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Vendimit Ref.AUV,01-320/2018 të datës 05.09.2018 është transferuar në vendin e punës “Kordinator i Zyrës Regjionale” në Mitrovicë, i cili me datë 16.03.2022 nëpërmjet e-mail-it zyrtarë ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1416/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim ankimor kundër vendimit për themelimin e Komisionit Disiplinor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.03.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës. Këshilli më datë 05.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 16.03.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 30.08.2021 për Themelimin e Komisionit Disiplinor; Vendimi i datës 05.09.2018 për transferim; Përshkrimi i detyrave të punës për ankuesin; Akt emërimi i datës 10.05.2018 me numër 3572; Përshkrimi i detyrave të punës për vendin e punës "Drejtor i Laboratorit"; e-mail i datës 04.04.2022 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/15.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, *është e palejuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, ankuesi sipas Vendimit Ref.AUV.01-320/2018 të datës 05.09.2018 është transferuar në vendin e punës "Koordinator i Zyrës Regjionale" në Mitrovicë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar me datë 16.03.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kundërshton Vendimin me numër të protokollit 5536 me Ref.AUV,01-405/2021 të datës 30.08.2021 për themelimin e Komisionit Disiplinor sepse mendon se kryetari i Komisionit Disiplinor ka konflikt interesi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, përcaktohet se: "Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative", ndërsa me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtar i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë", kështu që Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në këtë rast vlerëson se ankuesit edhe si palë e tretë nuk i janë cenuar asnjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës, rrjedhimisht nuk ka legjitimitet për parashtrim të ankesës kundër Vendimit me numër të protokollit 5536 me Ref.AUV,01-405/2021 të datës 30.08.2021 për themelimin e Komisionit Disiplinor.

Bazuar në këtë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mund të parashtrinë vetëm nëpunësit civil të cilëve i'u janë shkelur të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, kështu që meqenëse ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të Kosovës nuk i plotëson kushtet për parashtrim të ankesës sipas nenit 124 paragrafi 1, nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit

Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, atëherë e njëjta konsiderohet se është pa pranueshme.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

SHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.242/2022

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës;
- Udhëheqësës së Personelit në Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.